

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Nuk marrim pjesë në seanca", PDK: Do ta çojmë procesin e konstituimit në Gjykatën Kushtetuese
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/13/nuk-marrim-pjese-ne-seanca-pdk-do-ta-cojme-procesin-e-konstituimit-ne-gjykatën-kushtetuese/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 08:08:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	13 shtator 2026, 08:06:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 13 shtator 2026, 08:05:00 UTC → 13 shtator 2026, 08:07:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c47d18e64fdd1320d7a559b1f4a3d55385ae90dd29464df31208486feecef3c4
TEKSTI	108ad757bf7423dda4fc71fe689bf20d0df0a5087010deada5213e92be168970
PAMJA	851f8042dcfb0a72e9062b291153abb047675b18240c6152c1dc4520b64c39fe

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4c3ce712896b81a4c734fbcad2d61662e19ad124c5d25352a9ef2f28f91bddf2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4dbb247c3ea631ff8f2707e6b1f894f950e04cf248d4447a7ba057e4086fe8b1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4c3ce712896b81a4c734fbcad2d61662e19ad124c5d25352a9ef2f28f91bddf2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA DHE RAJONI **TË FUNDIT**

"Nuk marrim pjesë në seanca", PDK: Do ta çojmë procesin e konstituimit në Gjykatën Kushtetuese

13/09/2026 10:06



Partia Demokratike e Kosovës ka njoftuar se nuk do të marrë më pjesë në seancat e Kuvendit deri në një vendim të Gjykatës Kushtetuese, duke e konsideruar të bllokuar procesin e konstituimit të Kuvendit nga Lëvizja Vetëvendosje.

Përmes një deklarate, PDK ka argumentuar se afatet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit janë shkelur dhe se LVV ka vendosur vazhdimisht kushte të reja politike për përmbylljen e procesit.

Sipas PDK-së, Kuvendi është dashur të konstituohej brenda afatit 30-ditor, më së largu deri më 7 gusht, në përputhje me Kushtetutën dhe Aktgjykimin KO124/25 të Gjykatës Kushtetuese. PDK thotë se edhe afati i dytë, 6 shtatori, i vendosur nga Vetëvendosje, nuk u respektua.

Megjithatë, PDK deklaroi se mori pjesë në seancat e 9 dhe 11 shtatorit, me ftesë të LVV-së dhe me qëllim për të përmbyllur konstituimin e Kuvendit.

Sipas PDK-së, në të dyja rastet procesi u pengua për shkak të mosmarrëveshjeve për zgjedhjen e nënkryetarëve të opozitës.

PDK pretendon se e mbajti premtimin dhe votoi kandidatin e LVV-së për nënkryetar të Kuvendit, ndërsa kjo e fundit nuk votoi kandidatin e PDK-së për të njëjtin post.

Partia Demokratike e Kosovës thotë se tashmë LVV është shprehur e gatshme të votojë nënkryetarët, por e ka lidhur këtë çështje me mënyrën e votimit për Presidentin e Republikës.

"Për Partinë Demokratike të Kosovës, Kushtetuta nuk është pazar politik. Konstituimi i Kuvendit është detyrim kushtetues dhe nuk mund të kushtëzohet me votimin e opozitës për Presidentin apo me marrëveshje të tjera politike", thuhet në deklaratë.

PDK njofton se nuk do të vazhdojë të marrë pjesë në seanca të njëpasnjëshme, pasi sipas saj nuk ka garanci se procesi do të përmbyllet dhe se nuk do të vendosen kushte të reja politike.

Ekspertët e PDK-së, sipas deklaratës, kanë nisur përgatitjen e rastit që do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese dhe do të kërkojë qartësi për procesin në tërësi.

"Deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës mbetet i qartë: PDK nuk do të marrë pjesë në seancat e Kuvendit", deklaroi partia.

Në përfundim, PDK kërkon që të ndalen afatet e shkelura, kushtet e reja dhe pazaret politike, duke theksuar se tashmë "fjalën duhet ta thotë Gjykata Kushtetuese".

I Kryesore



Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, reagon sërisht Rama: Gjykatësi fillestar në Shqipëri merr 500 euro më shumë se kolegët në Greqi

09:22

"E duan rritjen që nga prilli 2023"/ Rama për vendimin e Gjykatës Administrative: "Prapambetjet" e pagave për gjyqtarët shkojnë në 130.5 milionë euro

16:04

U arrestua në Greqi si kreu i bandës së kokainës, kush është "i tmerrshmi i Beratit", saga e krimeve që akuzohet në Shqipëri dhe arratisjet nga burgu

21:33

Ambulanca përplas të moshuarin në Korçë, shoferi ishte i dehur e çon vetë në spital

09:27

Tritol banesës së mësuesit në Shkodër, zbulohet emri i pronarit të shtëpisë

22:22

I Më të lexuarat

Nuk ka "fund" droga e sekuestruar e "të tmerrshmit të Beratit", gjenden edhe 26 kg kokainë në banesën e Lulëzim Cakës, vendi ku e fshihte

U dhunua shtatzënë gjatë grabitjes, humbi fëmijën, 9 vite burg për "trurin" e sulmit ndaj Donnarummës dhe partneres së tij

Vdekja e Mazonakis/ Ngrihet alarmi nga mjekët, thirrje qytetarëve: Kujdes me terapitë alternative, informohuni për...

U arrestua në Greqi si kreu i bandës së kokainës, kush është "i tmerrshmi i Beratit", saga e krimeve që akuzohet në Shqipëri dhe arratisjet nga burgu

Vuçiç ndryshon 'pllakë' për Thačin: Në Paris mora "sinjale të ndryshme" për vendimin ndaj tij

Mësuesit në Shkodër i hodhën tritol në banesë, dyshohet se autorët 'paralajmëruan' vëllanë e tij, zbardhen emrat

SPAK sërisht para Kuvendit për masë sigurie ndaj Ballukut? Akuzat e reja ndaj ish-zv. kryeministres rikthejnë debatin për një kërkesë të dytë në Parlament

Harta e re Territoriale, Rama nga Vlora: Bashkimi do bëhet, e thotë historia dhe numrat

U arratis nga spitali grek, zbulohen fotot e të

I Kosova dhe Rajoni »



Vučić ndryshon 'pllakë' për
Thaçin: Në Paris mora "sinjale
të ndryshme" për vendimin ndaj
tij

12/09 20:40



Protestë në Bronx në
mbështetje të liderëve të UÇK-
së në Hagë, flet organizatori
Shkëlqim Hajdari: Kërkojmë
drejtësi jo mëshirë

12/09 18:40



"Marshi për Liri"/ Mbahet tubimi
në Prishtinë, mijëra qytetarë
mblidhen në mbështetje të ish-
krerëve të UÇK-së

12/09 16:30



Ndalimi i shqiptarëve në Mal të
Zi për simbolet kombëtare,
reagon ministri Dukaj: Flamuri
shqiptar nuk është kërcënim

12/09 14:58



Fjalimi prekës në Prishtinë,
vajza e dëshmorit: U rrita me
mungesën e babait dhe
xhaxhait, por me krenarinë për
familjen time

12/09 14:39



BE reagon para vendimit për
Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së:
Respektoni verdiktin e
Speciales, nuk është
përfundimtar

12/09 13:10

Na ndiqni:

Top Channel

@topchannelalbania

@tchbreakingnews

Top Channel

I Video »



Top Channel/ Jepet alarmi për
AI: Më e rrezikshme nga sa e
mendojmë



Top Channel/ Protesta rrethon
Kryeministrinë, policia zbret në
shesh



Top Channel/ Harta e re, Rama i
prerë: Bashkim do bëhet,
mbyllet brenda 2031



Top Channel/ Kapet në Greqi
vrasësi shqiptar, "koka" e
kokainës në trëndafila



Top Channel/ Berisha vjen nga
SHBA: Udhëtimi ripërtëritës i
jetë sime!



Top Channel/ Vdekja e
Mazonakis, mjeku ngre alarmin,
thirrje qytetarëve: Kujdes me
terapitë për...

dënuarit Gentian Çipit, ja si duket ai sot

U kap në Greqi, shqiptari misterioz i kërkuar
për vrasje jetonte në vilën luksoze në
Marathona, i gjenden 2 kg kokainë dhe armë
në banesë

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Bileta
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Kontakt
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.